

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME ENVER TOPILLËN

Prishtinë | 7 shkurt 2015

Kohëzgjatja: 90 minuta

Të pranishëm:

1. Enver Topilla (I intervistuari)
2. Lura Limani (Intervistuesja)
3. Kaltrina Krasniqi (Kamera)
4. Labinot Topilla (I pranishëm)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

- {) - komunikim emocional
- { } - e intervistuara shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

- [] - shtesë e tekstit për të lehtesar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale të jepin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

Enver Topilla: Quhem Enver Tahir Topilla i lindun me 18.08.1946-tën në fshatin Shkabë ish-Glladnasella, komuna e Drenasit. Përgatitje shkollore e kom Shkollën e Naltë të Industrisë. Fmi i kam tetë (buzëqeshë), pesë vajza e tre djem, t'martumë i kom të gjithë. Kanë fmi, jonë t'shkollumë... aq sa kom mujtë.

Babën e kom Tahir Topilla, e ka pasë shkollën e mesme t'kryme n'maqineri n'atë kohë. U kanë shef i stacionit t'trenit n'Dobroshevc dhe osht' burgosë si informbirojc dhe n'arkivin e Kosovës e kom gjetë nji dokumentacion dy-tre herë osht' dënu me kah njizet vjet burg të randë. I ka majtë me ndërpremje shtatë vjet. Për shtatë vjet unë s'kom ditë kush osht' prindi jem, dhe pas shtatë vjete diçka tanë kur osht' ardhë m'ka lindë vllau Sejdja. Baba përpara u kanë i fejum me motrën e heroit t'popullit Aziz Zhilivoda. Po, ajo ka vdekë, na thojmë ajo shprehja jonë popullore "nën unazë", hala pa e marrë, edhe me ni ren ia ka dhanë vajzën e vogël Shaban Polluzha, hero i popullit osht' i shpallun edhe n'Shqipëri edhe ktu, Shefkijen. Kanë jetu s'bashku shumë kohë, po rrëth babe janë bo tre-katër prova ku ka ardhë para vdekje.

Ma s'pari aksioni i parë n'1957-tën kur ka fillu n'Kosovë asht' aksioni i armëve. Asht' maltretu n'atë formën ma t'vrazhdë që mund të ban dikush n'jetë dhe prej Gradice jonë kanë në nji maresë t'ni pajtim t'gjakut, osht' dashtë për ni orë e gjysë me ardhë nëpër borë i dathun se mo s'ka mujtë me i mathë kupcat, s'ka mujtë me mathë kurgjo. Dhe iu ka bo nji paritje ktyneherë osht' kanë n'ato lëkurat e deleve, iu ka bo për pesë javë a gjashtë derisa osht' ardhë n'veti. Sa herë ka ardhë Hrushçov apo nga dikush n'Beligrad, baba m'u ka izolu dhe ka bo izolim, osht' lajmru kah dy here n'stacion t'policisë n'Drenas apo n'Prishtinë çdo here n'çdo kohë derisa n'81-tën, kur erdh... po mendoj e '81-ta derisa n'luftë tash që u bo lufta çlirimtare e boni mbrojtje t'familjes nji rezistencë shumë t'fortë e boni n'dorë të t'këtij djalit afër që e kam. Edhe iu ra atyne me format ma t'vrazhda dhe e pushkatunë n'dorën e tyne, ku asht' i shpallun hero i popullit... jo hero i popullit, po dëshmor i kombit... kërkoi falje.

U kanë pjesëmarrës i luftës t'Shaban Polluzhës. Rrugat, vrasjet nuk muj shumë t'i spjegoj ato gjana, asht' se çdo herë m'i kanë ikë bisedës për shkak se kështu ashtu jom kanë i vujtun edhe i ndjekun. S'kanë dashtë me m'pa t'baj me këtë punë, se edhe pse m'kanë detyru, noshta çdo libër, çdo roman, ja çdo gazetë me lexu me m'interesu krejt rrjedhat tona çka ka ndodhë e çka asht' ba. Si për shembull siç e kom lexu, p'e marr nji shembull, bohet nji roman, "Tradhtia" prej Kapllan Resultit, ku mirë shkruhet, "S'ka prag i

shqiptarit që s'asht lagë me gjakun e shqiptarëve; apo, nanë ja motër që s'kanë për i djalë a vlla shqiptari që asht' vra." Asi raste ktu ndodhënë t'gjithë shqiptarët.

N'Podujevë kur kanë shku që i kanë mashtru atë u ba iniciator edhe Fadil Hoxha. Jonë kanë grupe të... mos t'thom t'manipulume shqiptare për t'mashtrumë n'shumë raste. Dhe ndahen prej Podujeve vijnë n'Pestovë dhe n'Pestovë plagohet djali i madh i Shaban Polluzhës, Tafa, ku bon pjesë aty baba me ta dhe e marrin e çojnë ni shërim m'i ba në ...tu ni Bajram Shallci n'Shallc. Shaban Polluzha i ka pasë dajtë prej Shallcit, komuna e Vushtrrisë.

Edhe lufta ka qenë... janë kanë edhe aradhat partizane t'Shqipërisë n'bashkëpunim me kta tjerët, lufta u kanë shumë ranë, pesë javë, gjashtë pse Shqipëria tash mos t'e marrum a ka bo gabime, a s'ka bo, s'ka pas qare. Na e dijmë se çdo herë edhe kundër Shqipërije jonë kanë. Dhe një luftë u bo shumë e madhe, ku dyshëdhjetë mijë ushtarë i ka pasë lufta... veç Shaban Polluzha. Se i marrëm... po flas sipas dëshmitarëve okularë që kanë qenë n'luftë, po e marrëm një fjalor të Ded Gjo Lulit dhe Shaban Polluzhës, të dytë kanë qenë analfabeta që i kanë pri luftës dhe ministria shqiptare i thotë xhaxhit Ded, "Luftën e ki fitu me armë, puno me tru." I thotë komisarit, "Ktheje biro kondakun e pushkës, shkruje letrën," thotë, "Pushka t'i lun trutë, dhe çoja ministrisë shqiptare".

Operacionet e randa edhe arma kur përdoret jonë t'fundit, kur s'arrihet kurgjo me tjetër sen. Asht' bo luftë shumë e ashpër, për pesë javë a gjashtë. Edhe i nejti rast jonë malltretu edhe gra e fmi sikur na n'kit' kohë... edhe kur gjuhet kulla n'Tërsenik n'Drenicë osht' një fshat... me top, dhe vrahet Shaban Polluzha. Shaban Polluzha len amanet që mos me prekë dora e serbit po duhet, detyrohen kta me shku me gjue n'lumin Drenica. Asht' ktu te tunelli i trenit. Po e foli tash t'fundit, se Shaban Polluzha asht' kanë ai që e ka edhe filmin e inçizumë kur iu ka ba në Serbi, n'Sanxhak, ku asht' vis i banum me boshnjakë që iu ka dalë n'ndihmë dhe asht' një film i tyne, boshnjakët që e kanë inçizu, Shaban Polluzha kur o' shku me iu ndihmu për me u shlirue prej okuaptorit.

Labinot Topilla: M'fal po ndërpref, shqiptarëve edhe boshnjakëve o' shku me iu ndihmu?

Enver Topilla: O' shku ky si shqiptar me iu ndihmu boshnjakëve për me u çliru nga serbët, nga serbët me u çliru.

Lura Limani: M'fal a mundesh mos me ndërpere sa asht tu folë? Kur te kryne mundeni me bo pytje...po mendoj kur te kryne fjalinë.

Enver Topilla: Nejse, kërkoi falje, nashta se gaboj shumë. Mund të gaboj.

Lura Limani: Jo, jo nuk ka problem po veç mos me u dokë [ndërpërmja] në video.

Enver Topilla: Se asht n'pytje, se une e thashë, edhe u ba një kohë pak e gjatë, edhe ka njeriu... se t'folsh sa t'përvujtun shqiptarëve janë, ja për punën... një roman veç për një njeri mund ta shkrujsh, e le mo për krejt popullin. Dhe, asnjëherë nuk e kanë pranu okupatorin i cili asht'... nuk asht' vetëm i joni por, po

dihet, i të gjithëve, mo, i të gjitha republikave jugosllave. Dhe asnijihere njeri nuk mund t'i beson siç që po ndodhë rasti i nejte n'Maqedoni që ndodhi, s'di qysh u ba. Veç mund t'ndodhë edhe ktu pse nuk kanë besë t'mjaftushme. Jo pse i urrej une, por bota e din edhe i vërteton qashtu.

Tash t'e marr nji biografi temen t'shkurtër. Jom kanë ushtar i ushtrisë jugosllave, atje m'shan ni serb, "Šiptarsku majku", "Nanën e shiptarit," dëshmi kam nji Nehazirin i Zabelit t'Ultë, edhe nji Murat Bajraktari. Edhe s'muj ta baj, edhe i bi me atë thikën e pushkës, i bij n'kamë edhe s'di ma çka bahet. Po une m'ndodhë parabetimi edhe s'un ëm dënojnë n'atë kohë.

Masanena jom punësu n'fabrikën e amortizorëve n'Prishtinë, kom punu 15 vjet. N'1979-tën çohna na lidhin me nji Reno servis t'Beligradit dhe çohna jom kon udhëheqës n'venin e punës n'automatika kur jom kanë n'specializim në Gjermoni në Bielefeld për atë punë. Dhe i kundërshtoj, vijnë e m'marrin n'vend t'punës me kerr t'policisë, me kerr t'mbyllun n'79-tën m'malltretojnë mjaft, më malltretojnë gjysë... serbët e shqiptarët e prishun n'shpirt {qan}. Edhe për dy vjet deri n'81-tën që m'rë natën e majit n'izolim, m'kanë izolu pa procedurë gjyqësore me 30... qysh p'i bjen prill a? Natën e majit dhe i boj tre mujë ditë n'izolim pa vizitë, pa e ditë familja ku jam. Do n'Lipjan, do e boj n'Mitrovicë, n'burg t'Mitrovicës, nji burg mjaft asht' i randë e bojmë n'podrum. Kur italianja kur e ka konstruktu atë burg, nji italiane bon vetëvrasje, thotë, "Une si njeri kom bo ku nuk jetohet". Burgu asht' shumë i randë, nji ndër burjet ma t'randa asht burgu i Mitrovicës ku jom majtë aty për një kohë t'gjatë.

M'duhet tash t'shkoj nga ajo që vujtjet e familjes janë kanë shumë t'randa. M'u ka thy... e kom pasë nji banesë në shtëpinë e studentëve 2 në Prishtinë nga fabrika e amortizatorëve. Ajo m'thehet disa herë edhe m'merret i gjithë dokumentacioni çdo gja para shpije që ka mbetë, nuk m'len Shërbimi i Sigurimit Shtetëror, serbisht "Državni bezbednost" [Sigurimi Shtetëror] ku u thirrë... Prej atuhit, prej Mitrovice m'kthejnë edhe fillojnë hetimet. N'gusht e marr ftotfjen e mushknife për shkak kushtet jonë kanë tejet t'rana n'burg n'numrin katër edhe tre, ku pas nji kohe pas një dënimisë 14 vjeçar e kthejnë Jakup Krasniqin.

T'dytë n'beton, vendet shumë t'randa, aty e marr ftotfjen e mushknife dhe maltretimet kanë qenë për 27 herë, 17 herë vij para deke prej maltretimeve t'tyne. Dhe vendosi thom, "Muj t'vdes e asnji njeri s'uj [s'muj] ta dha se jonë kanë nji milion shqiptarë n'demonstrata". Nji milion shqiptarë jonë kanë. Bahen dëshmi do njerëz t'prishun edhe për 17 herë maltretime asnjisherë nuk m'bjen asni dorë e serbit, edhe pse kom pasë inspektorë t'Sigurimit Shtetëror, jonë kanë t'Plevlës t'Malit t'Zi, do shqiptarë t'Medvegjës n'shërbim t'Sigurimit Shtetëror Jugosllav i bijnë ndihmë dhe ata m'bijnë n'gjendje para deke.

M'qesin n'gjyq dhe nuk mun um dënojnë pa e vërtetu mjeku a jom i përgatitun. M'çojnë n'Prishtinë tu Skender Boshnjaku, neuropsikiatri, dhe Skender Boshnjaku e jep që unë nuk mund t'i përgjigjna procedurave gjyqësore. Dhe m'çojnë n'burgun qendoror t'Jugosllavisë, serbisht Centar zatvora – burgu qendoror dhe i boj gjashtë mujë ditë shërim n'spital prej maltretimeve që m'bahen. Edhe ata, edhe unë që jom i papërgatitun, por neni 114, kundër revolucion, shkrunk mirë edhe gjykatesi Elez Hoxha, tash asht' n'burg për ni gabim pas lufte çka kanë marrë, çka po di, gabimet e tyne janë... duhet tanë të përgjigjen si

ai ndoshta... N'putonin e shkrun shumë mirë, thotë, "Dënohet pak për shkak t'shëndetit që nuk kem t'drejtë me qitë n'gjyq hiq", dhe i maj ditë m'ditë dy vjet.

Pasanej vij n'shpi, vazhdojnë procedurat, ma shumë familjare, "Jo Tahir Topilla," tha, "I dënum, baba jo, babegjyshi Shaban Polluzha." Vujtjet s'ëm nalen kurrë edhe dënohna edhe pesë herë me ka nji mujë, dy mujë, sa here kom dalë n'Drenas që m'kanë dënue. Punësohna në ni formë në "Feronikel" e m'hjekun masi i kom bo gjashtë mujë e gjysë kom fitu dhe kur um qesin n'gjyq, më thojnë, "S'kem çka t'bojmë se dy pa mend, ni pa kokë. Ti je pa kokë për momentin, s'kem çka t'bojmë." A di kshtu, tani shqiptarët para gjyqit. Pesë-gjashtë vende t'punës m'i ndrojnë, po pas lufte t'u e ditë familja çfare asht', t'u e ditë vujtjet cilat janë edhe... edhe pse jom kanë shumë i smutë prej unazave, që jom bo operacion t'rundë pse s'mu ka hekë kurrë brohnitis kronik që kom marrë n'81-tën n'burg.

Dhe blej pushkën...s'kom pasë kon m'e çu n'Prishtinë... blej ni pushkë automatike 20-she dhe dal si ushtar i Ushtrisë Çlirimtare t'Kosovës, ku jam veteran edhe i luftës. Edhe djali ai profesori pa i bo 18 vjet, m'del edhe vllau dhe dalum n'luftë. Po, ka qenë rrezik i madh se çdo herë t'i kanë marrë krejt familjen përpara, dhe s'ke pasë kurrefar kushte ti as me bo diçka për shkak se ni vrasës me t'u bo shumë e shkurtë kur e ka pasë familjen përpara t'vrajke sa t'dojke. Ka pasë edhe njerëz që m'i lypshin familjet, kanë shkru gazetat që jom konë pjesëmarrës i fortë atë ditë kur u vra Fehmi Lladrovci e Xheva Lladrovci. Kur u vra, m'u ka vra si na që jem n'shoqëri qitu, Shefqet Zekaj i Prishtinës n'trafo stacion. Atë ditë u kanë i 22-ti shtator 1988-tën, '98-tën.

Tani ka shkru gazeta dhe maltretohen... fmitë i kom pasë n'banesë n'Prishtinë, une banor i Prishtinës jom kanë kështu me dokumentacion dhe për katër herë ma lanë afatin e fundit n'rast që nuk lajmrohna, me m'i kidnapu fminë. Edhe hi ilegalisht, bile ka vdekë njeriu, personi i cili m'i ka majtë fminë dhe çdo herë iu kanë çue bukë e millë fmijve n'banesë shoqata e "Nënë Terezës". Edhe aty u kanë Engjell Ukshini që kom punu me to n'Amortizer, dhe ai si e ka ditë ku i kam fminë ku janë s'mi ka kursy, çdo herë ju ka çu veshje, bukë, fmijve u ka çu n'banesë. Jom hi ilegalisht ku u kanë OSBE-ja dhe OSBE-ja ka marrë mi veti që atë ditë n'10 ora me shku me mi pshtu familjen, m'i kanë pshtu familjen me përjashtim vajza m'u ka nda. Vajza o' kanë n'Fakultet t'Gjuhës e Letërsisë dhe ma kanë majtë shokët n'Prishtinë përderisa ka përfundu lufta. Unë s'e kom ditë që ajo o' gjallë kurrë, a kta tjerët m'i kanë lshu {qan}.

M'i kanë lypë familjen m'i pushkatu, m'kanë pshtu po m'kanë dalë ballë. Baba ma s'pari m'u ka vra, 84 vjeçar, ka rezistu, n'dorë t'këtij djalit. Tani m'u ka vra djali i motrës ushtar i Ushtrisë Çlirimtare t'Kosovës. M'u ka vra axha, m'u kanë vra dy djem t'axhallarëve edhe dy djem t'djemëve t'axhallarëve. N'shpi temen tetë-nantë rasa [gur t'varreve] m'u kanë bo me përjashtim që o' djegë çka ka sen osht'... me traktora, me kerre, me krejt çka i kom pasë, m'i kanë marrë. Dhe e kanë bo atë dom të cilin si zakonisht në çdo shpi shqiptare.

Po, kur nalna me i analizu shumë gjana, populli shumë ka qenë i vujtun, nuk asht' ba vetëm nji luftë, janë ba shumë luftëra. Çdo herë asht' sulmu Drenica, mos te marr, se na jena lutë n'Drenicë, "Ishalla n'atë

pjesë t'Kosovës nuk sulmohen,” se janë vende t'papërshtatshme për luftë, edhe pse tu na nuk osht’ një pyll i posaçëm. Tokat e rrugët krejt t'matne prej gjeodezisë jugosllave. E kanë ditë arma e tijna ku vendoset e ku e qet. S’ke pasë as qysh mbrohesh, tonë ka qenë armatimi shumë i dobët, po betimi osht’ bo, “Do t’luftoj deri në vdekje për çlirimin e atdheut”.

Dhe do t’kthehnë n’venin e punës edhe pse pasanejna jonë bo do gabime mjafë të cilat nuk i kanë pasë hije dikuj-dikuj, a për luftë jonë kanë shumë t’shkëlqyshëm shqiptarët. Falë Zotit se asni shtet s’o çliru, asnihere pa i ndihmu dikush tjetër, dashtë Zoti Amerika, dashtë Zoti popujt që e kanë ditë çka o’ vujtja. Dhe populli osht’ n’qit gjendje tash sa... nuk o’ krejt e knaqshme po edhe nuk osht’ edhe e keqe, nuk mund t’thom që o’ e keqe.

Tash, mburrna n’shumë aspekte me ne, n’jetë um merren vujtjet çfare t’dojnë kur ditë kon e kom babë t’nanës, ni Shaban Polluzhë, një 74 vjeçar i ka pri me 12 mijë ushtarë luftës. Ju kanë burgosë tani djemtë, e ju ka vra djali e o’ vra vet e s’ka pranu as me ia prekë kufomën. Ia kanë maru tash përmendoren shqiptarët amerikanë, shqiptarët amerikanë që punojnë.

Edhe iu kanë marrë tokat e iu kanë konfisku çka ka sen para shpirti. Baba t’njejtin rast i ndodhë pse dhondër i tijna, edhe si informbiroist edhe ai derisa m’i vrasin se osht’ deka... njeriu lindë për me vdekë po pas vdekje çka i mbetet. Atyne iu ka mbetë ‘Hero i popullit’ dhe mburrna që e kom... babë e babëgjysh kon e kom pasë.

Në t’njejtin rast mburren fmija i mi se i kom shkollu me shumë mundime, edhe pse pas lufte jom ba prej tonë partive n’komunë t’Drenasit i treti. Dy mandate i votum ma s’shumti si n’ansamble komunale si këshilltar, edhe kryetari i bashkisë ku i kom pasë 215 t’vramë n’pesë fshatra – n’Gradicë, Likoshan. Pushka e parë si në Vlorë, ka kërsitë n’Likoshan. N’Glladnasellë tash Shkaba aty, Dritoni i Dobroshevcit, Çikatova që i kom pasë 215 t’vramë, a veç fshati jem i ka pasë 93 fmijë bonjakë nën 15 vjet. Të gjitha ato fshatra jonë konë t’djegme prej 75 përqind deri 90 përqind të gjitha jonë kanë krejt t’djegme. Krejt shtazët e vrame, shumica edhe pemët e preme, krejtve na u kanë marrë traktorat e bujqësia e... s’di çka s’na u ka bo n’shpirtin tonë. Për atë arsy’ nuk muj t’thom ma ndryshe se sa u bona që jom shqiptar.

Edhe nihere po e lidhi ato, “Feja e shqiptarit o’ shqiptaria”. Të gjithë jena konë unikë edhe lufta fitohet vetëm atëhere kur t’bahet prej bujikut deri n’akademikun kur i hijnë një procedure atëhere lufta o’ fitorja e popullit, asht’ e këtij popullit t’sinqertë. Po e marrë tash fminë e mi, mburrna që i kam, edhe kta mburren që m’kanë prind. Dij me kanë i vrazhdë kajherë veç për interesë t’tyne. M’u kanë shkollu mjafë, asnji bursë nuk e kom marrë se n’rast që kanë mendu me m’dhon dikush kom thonë, “Jo, se une muj t’i maj fmitë, jepni dikuj n’varfëri”, edhe pse jom konë në t’gjitha komisionet.

M’u kanë tregue... i kanë kry krejt fakultetet, fakultetet t’shtetit e jo private, edhe djalit ia kanë mundësu Universiteti asht’ n’FSK, osht’ t’u dokturu 29 vjeçar metalurgjinë n’Turqi, n’Universitet, një fakultet i cili prej 117 a 30 sa jonë universitete, asht’ i 17-ti me renome botërore. Dhe edhe një here po e thomë, për mu jeni

t'mirëseardhuna, jeni shumë t'sinqerta, i duheni popullit shumë se njeriu te flet realitetin për kohnat t'cilit ka qenë, e kanë hupë kokën çdo herë, a kur o' mohu realiteti asht' hupë nderi, a o pshtu koka.

Për mu jeni... e keni nderin e lartë, ju respektoj shumë si me ju pasë evladë t'mi, jo pse pe bani një intervju me mu, po derisa nuk t'a do zemra, edhe kësaj procedure s'i hi kërkush. Juve ja u do zemra drejtësinë, realitetin.

Kur e marrsh, veshja kombëtare ta simbolizon edhe ardhmërinë tande, shtetin tond, t'kalumen tande, edhe me kangë. Se atëhere n'ato kohna asht' dashtë për shembull t'knohet "Azem Bejtë, Azem Galica, ja panë sherrin krejt Drenica," mendoj që o' dashtë me knu n'atë formë sa t'vrazhdë. Ose për Shaban Polluzhën, po për Shaban Polluzhën kur knohet ilegalisht, knohet shumë kangë për to. Dhe thuhet, "Hajde, hajde o Shaban Polluzha," thotë, "shumë mirë po qet, të lumtë pushka, shumë shkina na i le vejushka".

Kangë popullore po flas, siç knohen çdo kund kto jonë normal. Po te shqiptarët se shqiptari ka lindur me muzikë, asht' rritë me muzikë, vdes me muzikë. Ato e din fort mirë çdokush se nana kur fminë e lind, dhimtë e saj dashni bohen për atdheun, t'fmisë. Dhe kur e knon "Nina-nana, n'djep të drunit ti mu bofsh plak i katundit", ose "Kalle, kalle qitja timin na p'e martojmë filan trimin", ose "Ma ke lonë pushkën vjerrë," kur vdes fmija, njeri edhe tri kangë i bafen. Po te shqiptarët mendoj qartë edhe muzikën na e marrin, na e asgjasojnë forcat tjera. Për shembull lahitën ta merr Mali i Zi se u kanë shtet ose, gjajtë t'i merr Maqedonia ose fyllin t'a merr Serbia, dhe ty t'mbetet çiftelia. Çiftelia o' familje e sharkisë, e sharkia turke. Edhe muzikën na kanë asgjasu njerëzt e këqijë, armiqtë e këtij populli.

Une edhe nihere po e thomë, ndoshta kom lonë sene shumë mangu me folë me ta duhet t'bajsh romane veç për ni person, e le mo për ni popull. Kom lexu shumë libra t'shumë njerëzve, po pa marrë parasysh qysh e çka, për t'gjithë t'kalumen e vujtjet e mijë n'shpirtin tem, ja vrasjet e familjes, ja t'gjyshëve, ja t'prindëve, janë t'dhimshme shumë. Po, te njerëzt e mençëm njerzitt e dijshëm duhet me i përkujtu, a njerëzt e kqijë duhet me t'u dhimtë pse s'u kanë edhe ky i mirë kur Zoti ia ka falë menjën e sytë të tjerëve. Dhe për atë arsy, edhe nihere ju falemnderoj me krejt shpirtin.

Pjesa e Dytë

Lura Limani: Ju folët pak për babën edhe na tregutë që shtatë vjet, nuk e keni ditë as kond e keni babë se ka qenë n'burg. A po na tregoni pak ma shumë çka ka ndodhë mas përfundimit t'Luftës s'Dytë t'Botënore edhe mas vdekjes së Shaban Polluzhës edhe specifikisht me babën e juj?

Enver Topilla: Pasi kom lindur unë, n'46-tën, 1946-tën baba asht' burgosur. Une kom jom kanë si fmi, edhe denohet 20 vjet politikisht. Denohet ni grup, tetë vetë m'duket dënohen me vdekje dhe ni grup prej disa anëtarëve, nuk e di, ku baba bon pjesë, u kanë orator shumë i fortë atëherë me shkollë u kanë, dhe

denohet 20 vjet. Lëshohet po m'doket mas 11 mujve sipas fjalëve t'tyne. E marrin në procedurë t'shpejtë edhe e çojnë n'izolim edhe dy vjet e përmi e çojnë n'izolim pa gjyq. Dhe, kur marohet burgu i Prishtinës, maj n'men e kom ni veten mjافت t'rritun kah katër-pesë vjet, me mixhën jom ardhë e kom pa, bajshin tjegulla me atë kutinë t'vjerrne n'qafë t'mushne plot, pa ashensor, pa lift, pa as send... dhe e ndërtojshin burgun, si i burgosun.

Veç, komplet t'e marr... ma shumë jom rritë te dajtë n'Polluzhë. N'Polluzhë kallen krejt shpijat ju kallen. Dhe atje kom shku ma shumë kom ndejt se nana pa burrë. Ma respekton mixha shumë nanën dhe pa babë e pa vlla, dhe shpijat krejt t'djegne jonë konë n'Polluzhë, i ka pasë shpijat, ka pa[s] ...u kanë pasunik. Shaban Polluzha s'ë ka bo luftën pse s'ka pasë, po ka dashtë t'kanë të gjithë baraz, të kanë të gjithë lirinë, të kanë të gjithë nderin, pse nuk u kanë ni njeri i varfër se ka pasë mjافت tokë, po i merren të gjitha.

Dhe, fort mirë e dij kur baba vjen, për qato vjet e mijë veç nihere jom kanë n'vizitë si fmi. Qysh i ka ndodhë edhe mu ky profesori, ky Fatoni vjen pas 17 mujve, vjen n'Ferizaj n'burg dhe e pyti grunë, "A po din djali me folë?" E shtin djali dorën n'ato telat dhe m'prekë n'ftyrrë {prek faqen} me gjoja, "Pse s'po m'ptytë mu po, po e pytë nanën?" Qasi rasti m'ndodhë edhe mue.

Po, babës m'i dhahet nji inxheksion në krah, nuk është me rëndësi kush ia jep se s'po du me etiketu njerëz... i anës tonë, me helmu. Dhe i bahet nji pjesë shumë e damshme n'krah {prek krahun} dhe i duhet, bahet shumë nervoz i madh para shpije, po pshton. Dhe i duhet ni doktor, ka qenë ni Manevski i thojnë maqedonët dhe ia bojnë operacion, ia hjekin krejt pjesën e mishit dhe ia nxjerr zyrtarisht atë pjesë babës edhe pshton pa u çmendë prej asaj dhimte. Çdo herë mo asnji t'drejtë s'ka pasë drejt Lidhjes Socialiste me votu, s'ka votu nana, s'kom votu as unë masi nana e baba s'mkanë votue.

Asht' kanë shumë i përgatitun, po menoj, me shkollë. Atëhere mungesë shkolla te njerëzit dhe u kanë shumë herë, çdo herë pjesëmarrës i Pajtimeve t'Gjaqeve, ndërmjetësimëve. Edhe pse ndoshta ni darsëm me kanë që u knu ni kangë patriotike, e kanë marrë kto, "A ke ti aty? Qysh u knu? Çka u ba?" (buzëqeshë). Çdo herë prej maltretimeve... kurrë s'asht' mposhtë asnihere n'jetë (qan). Dhe, me marrë tash rr Ethanat e tijna, shumë herë m'vrasin n'shpirt.

N'rast se veç nihere kom mujtë me ia kthy nji fjalë, ndoshta me t'keqe, jo me t'keqe, po atë çka ma ka thonë, e ka ditë atë çka mund t'i ndodhë njerit, a çka mund të m'ndodhë mu. Për atë arsyе tanë une shumë herë unë e kom çu nëpër pajtime, jom kanë i ri po s'u kanë te na nji traditë, se për 54 vjet' e mijë, n'jetën tem nji qind herë n'koftë hi a kon dalë, kurrë ulë pritë s'e kam, s'e kom pritë kurrë ulë. Çdo herë edhe kur i kena nxjerrë eshnat e Fazli Grajçevcit edhe me shokë e me aradhë, çdo herë kena organizu kena pritë, kena ndihmu edhe n'pajtime t'gjaqeve edhe n'tona gjanat. Falë Zotit qi e murrë i madhi i këtij populli, Anton Çetta ni iniciativë edhe e nali vrasësat n'Kosovë, edhe pse aktuale jonë hala. Po, e ka bo nji punë që s'kish mujtë as lufta, as paqja m'i rregullu atë çështje e cila u rregullu n'pajtimin e gjaqeve.

Pasanenaj, pas luftërave e mora atë iniciativë edhe unë, pse e banë ato Shukrije Gashi, e bamë trajnime, kjo u konë drejtoreshë e ndërmjetësimët. Kena nihmu shumë me amerikanë edhe na, edhe na fillum me

pajtue çdo gja çka ke e keqe para lufte edhe gjatë lufte. Për atë arsy, janë qito shumë gjana që po e thomë edhe nihere. N'data s'muj përqendrohna shumë për shkak t'smujes tem e cila asht'... dhe edhe nihere p'e thomë që çdo herë bilem i ka ikë bisedave se e ka ditë që une s'rahatohna kurrë. N'qat sistem i kom' edhe fmitë, muj të thomë çka di edhe çka asht'. Çdo gja çka asht' e tepërt, vret n'shpirt kur e thotë dikush e le mo ta thomë unës.

Lura Limani: E përmendët që edhe pse keni qenë t'u jetu n'Prishtinë edhe keni punu,' jeni konë në njifar mënyre i papërshtatshëm. Kur keni fillu me u marrë po supozoj, me "Illegalen", edhe a muneni me na tregu naj ngjarje specifike para se me iu futë n'burg edhe mas?

Enver Topilla: Po, shiqo, unë po ja u thomë unë jom konë 22 vjeç n'ushtarinë jugosllave, vetëm pse m'shahet me dëshmi përmenda njerëzit, pse m'shahet nana shqiptare i bij thikë, e le t'bajnë çka t'dojnë, me thikë t'pushkës i bij nji shkau. Dhe, plus kur nuk mund të m'dënojnë për shkaqe se jam...s s'jam kanë betu hala. Para betimit s'ka pasë ligj me t'denu. Dhe e bajmë krejt shokët që kur t'lshohem atë ditë prej ushtrie te marr te blejmë plisat e bardhë edhe dhe, vetëm mu ma çojnë, vetëm në n'mëngjes në Mostar, në Trebinje, plisin e bardhë dhe m'betohën që, "Ti kurrë s'ke me pa ditën tone," eprorët ushtarakë, atë ditë që t'lshohna prej... 20 vjeçar.

Po, ata jonë kanë... atëhere aktivitetet jonë kanë shumë t'randa se unë po thomë, njeriu nuk din me mendu ma ndryshe, ti për shtatë-tetë vjet taman sa... u ba, kur t'nalesh me menu jo për vrasje, jo për gabim, jo për hajni, po kundër pushtetit sllav, kundër padrejtësijave. Padrejtësinë e kena urrejtë gjithë, me krejt shpirtin, e kom urrejtë çdo herë. Çdo herë kur o' dashtë mledhje pasi jom punësu, jom çu se jom punësu para se me shku n'ushtarinë jugosllave.

Çdo here e kom kundështu padrejtësinë, çdo herë jom maltretu, çdo herë jom marrë n'pytje, çdo here m'u ka thy banesa n'69-tën. Ma ka dhonë fabrika e Amortizatorëve banesën për shkak të pregadtijes teme që e kom pasë. Atëhere organizatat kanë nda banesa, dhe sa here jom shku m'u ka dashtë me ndërrue pesë mujë a gjashtë mujë cilindrin e derës që jonë shku ma kanë thy pa prezencën teme, Shërbimi i Sigurimit Shtetëror. Dhe, nuk e di çka duhet ma shumë që asnihere s'kena votu si njeri kurrë, pse baba s'i ka pasë të drejtat e Lidhjes Socialiste atëhere. Nana, çika e Shabanit nuk ka shku me votu për shkak t'babës. Dhe unë për shkak t'babës e t'nanës asnji votë n'shpirtin tem kurrë s'ja kom qitë jugosllavit.

E aktivitetet tona nuk jonë nalë kurrë. S'mu kanë nalë edhe fmija kur jonë ba, s'mu ka nalë as nga dajtë e as nga na, por jonë konë do aktivitete pak ma t'randa. Se s'ka mujtë çdo kush me i hi aktiviteteve. S'kom mujtë as unë kur i kom pasë përpara babën, e familjen t'vujtun e t'shkumë. Edhe, mysafiri që na ka ardhë neve, u dashtë me na ardhë natën, natën me na ardhë. Dhe bile nji rast, kur t'lshohna prej burgut më thirrin n'stacion t'policisë, n'83-tën, edhe nuk shkoj. S'du me shku. M'thirrin tri here me m'marrë me forcë. Kur shkoj e shtin dorën n'xhep nji komandir i stacionit nji shqiptar thotë, "Kush je ti mos me ardhë?" Thomë, "Unë e kom kry atë temen, çka don ti me mu?". M'flet shumë mirë, s'e harroj kurrë. Thotë, "Ti po i përcjell njerëzit, po vijnë natën me t'pa, po i përcjell nëpër misër arave, s'po i qet n'rrugë." Thotë, "Edhe

po i përcjell njerëzt. Na e dijmë krejt kush po t'vjen, e qysh po t'vijnë. Po t'vijnë tre forma njerëz: njo me t'kqyrë ça t'ka gjetë, dy me t'kqyrë çka po mendon ti hala, edhe e treta qysh t'u ka kajtë nana,” shprehët, “çka t'kanë bo nëpër burgje”. Edhe ktu që i bana gjithë kto fjalë, çdo herë kur asht’ kur asht kanë m'u ka dashtë t'jem aktiv.

Lura Limani: A po na tregoni pak për punën edhe përvojën e juj t'90-tave pasiqë keni punu në Ferronikel masi që keni dalë prej burgut...

Enver Topilla: Po.

Lura Limani: Pastaj çka ka ndodhë?

Enver Topilla: Pas vujtjes t'burgut, kom nejtë nantë muj pa punë, dhe i kom pasës gjashtë fmijë. Jom punësu me konkurs, s'kom njoftë kërkonin dhe i kom bo gjashtë mujë e gjysë punë. Pas gjashtë mujë e gjysë, nji drejtor i kuadrave, shqiptar, ni nënshkrim karakteristik edhe i shkrunë Komitetit Komunal t'Drenasit, “Njeriu,” thotë, “e ka fitu marrëdhanien e punës,” gjashtë mujë fitohet marrëdhania e punës, thotë, “ndaqi merrni masa, përgjegjësia ju mbetet juve”. Dhe, dy orë, për dy orë bohen i dhajnë njanit, “Çoja vendimin për me shku prej shpije.” Ai thotë, “Jo, se nuk ia di asnjë t'keqe, ka me majtë familje. Qitëm edhe mu!”. Po e marrin tani tre vetë, se ka pasë nji organizatë prej nji mijë punëtorëve, 20 vetë s'kanë punu kurgjo, jonë marrë me thashethame që i ka pagu pushteti sllav. Gabimet e atëherëshme. Dhe ma bijnë, edhe unë shkoj t'u keshë te shpija, kajnë krejt rrëthi. Pse m'largojnë prej pune, kajnë të gjithë.

Jom shku tani kom mbetë pa punë. M'kanë pranu n'Skenderaj nji organizatë, s'kom dashtë me iu bo barrë mo kërkujna. M'kanë pranu n'mënyrë sipërfaqësore n'Bardh n'Kombinat, tash n'KEK – elektro... çka asht’ KEK-u. Dhe masi kom fillu punës, i kanë marrë njerëzit n'pytje krejt, edhe jonë kanë n'gjendje shumë t'rundë me i burgosë, “Pse e keni pranu”. Kom keshë kom thonë, “Qe une ku jam, s'ka nevojë kto”. M'kanë dënue për armë, m'kanë dënue për fminë që s'i kom çue n'ushtime ushtarake, m'kanë dënue edhe pesë herë. Ka ni mujë, ni mujë e gjysë, kah 25-26 ditë, veç edhe pesë herë i dënum masanejnaj, katër vende t'punës. Pasanejnaj m'kanë pranue, vendi i pestë asht’, kur m'kanë pranue n'Ngrohëtore t'Kombinatit, Kombinat i kanë thonë përpara KEK-ut. Dhe kom punu 18 vjet, gjashtë vjet e gjysë i kom bo pushim t'dhunshëm qi m'kanë largue, apet t'tgjithë... derisa u bo organizimi i Ushtrisë Çlirimtare t'Kosovës. Pasanenaj, jom konë i largum nga puna dhe kah gjysë rroge m'u ka dhonë ...aty. J

om konë n'vend t'punës krye-punëtor, udhëheqës i ni vendi, dhe, kur u ba Ushtria Çlirimtare e Kosovës, jom kyçë me ni rend, ditët e para jom kyçë.

Lura Limani: Cilat vjet jonë kto?

Enver Topilla: Asht’ viti '98-ta, viti '98 kur ka fillu Ushtria Çlirimtare e Kosovës edhe s'kom pasë kon me e çu n'Shqipëri me m'marrë armë, se zakonisht ne s'kem çka i bojmë, jena armatosë prej Shqipërie. E kom ble armën 1500 marka, unë edhe Adem Nika n'varfëri tonë, Adem Nika asht’ drejtor në “Kosova Siguron”.

Bile vllau, atëhere s'kom pasë pare, m'a ka ble qi asht' ushtar i Ushtrisë Çlirimtare t'Kosovës edhe invalid i mjeksisë osht, Sejdi Topilla, vllau. M'a blen armën thotë, "Dalsh, si t'dalsh o' ktu"...ushtar.

Në ni rast, n'Verbovc, n'shpi të Tafë Rukiqit, Tafa edhe Ajet Rukiqi t'dënum jonë konë politikisht, shokë i kom pasë, dhe, me ni telefon satelitor t'Fehmi Lladrovci, Fehmi Lladrovci asht' nxanë, tash vllaun e ka ambasador n'Shipni Ramizin (buzëqeshë). E Fehmi...me telefon t'tijna ka qenë minuti i telefonit satelitor 18 marka, dhe mas një 40 minuta, kom raportu t'shpisë të Tafë Rukiqit. M'ka lidhë drejtpërdrejtë Ramizi n'Bruksel, kom raportu ku me ra NATO-ja, kom raportu unë. Jo që po e thomë unë, po dëshmi jonë konë 20 vet, muj t'i numroj ko'[kënd] t'dush. Dhe jom munu me pshtu "Feroniklin" me krejt shpirtin mas shtatë... se m'u dhimke "Feronikel", se osht' fabrikë me shumë renome. Dhe pas ni jave i bojnë "Feronikelit" 34 projekte NATO-ja i bjen "Feronikelit", s'kom mujtë me i pshtu absolutikisht.

M'u ka dashtë t'i raportoj sa veta jonë t'vramë, ku ekziston ushtria jugosllave. Që vetëm n'fshatin tem prej 200 shpive, 14 punkte jonë konë t'policisë edhe t'ushtrisë...m'fshatin Shkabë, n'Glladnasellë, ish-Glladnasellë ku jonë 73 t'vramë. Kjo asht' ajo që m'u ka dashtë t'kyçna me krejt familjen, dhe te bojmë qat luftë, edhe qato mundime. A për punën që e thashë, asnihere s'kom mujtë m'u stabilizu, çdo herë ndoshta m'u ka dashtë për vjetët e mijë m'e pre tjegulla, tulla, e me shitë me i majtë fminë. Se baba papunë, i smutë, fminë m'u ka dashtë me i majtë, e qështu...

Lura Limani: Pas '98-tës, ju i jeni bashkangjité UÇK-së. A po na tregoni pak për kohën e luftës edhe po supozoj kur veç keni dalë bashkë me dajlin e juj n'mal?

Enver Topilla: Fshati si fshat i joni tash jonë bo pak ma shumë ushtarë, po unë kisha me vepru si t'isha pytë unë, t'isha kanë faktor... i gjithë populli shqiptar u kanë n'luftë, të gjithë janë veteranë t'luftës, për mu po flas. Jo me dallu tash kshtu, mu s'po m'pëlqen kshtu. Pse edhe nana që e ka dhonë bukën, edhe ajo që i ka strehu fminë, edhe njeriu që s'u nda prej familjes t'vet, edhe njeriu e ka ditë që po vrahet edhe s'ka hekë dorë nga ajo, se populli shqiptar u kanë shumë i vogël dhe jonë bo shumë ushtarë. Po ma mirë u kanë si n'Francë të gjithë me i bo ushtarë, me i bo veteranë t'luftës po flas, veteranë. Se sistemi jugosllav u kanë shumë i keq, po edhe ni gru n'rast se ja ka la dikujt do kpuca, ja nipar qorapa e kanë shkru që e ka nihmu ushtrinë. Shqiptarët tonë kanë punu për luftën, prej akademikut deri te bujku.

Lufta ka fillu te na... ma s'pari ka fillue n'Likoshan. Vrahet nji familje Xhemaj, 11 vetë. Mbrohen nga të gjitha anët, vijnë... po atje ne... ka qenë e papërgatitne sa duhet se lufta nuk shkohet, duhet m'u përgatitë noshta tri vjet për me luftu nji orë, ja pesë orë... jo me shkue qysh mendojnë njerëzit. Dhe, në ni t'pame na vrahet nji djali në trafo stacion, ni Abdullah Nika. N'fshat asht' kanë ni tollovi shumë e madhe, kur kanë fillu helikopterat edhe aeroplanat edhe mjetet, kom shku n'fshat t'tonin kom shku drejtpërdrejtë me kqyrë çka po bahet. Dhe, i marrin dy djemë, njo të Qirezit, njo t'Baksit dhe i marrin me veti, njani t'u shitë cigare, njani t'u e thurrë ni gardh. Dhe i bijnë n'Likoshan e i lidhin për ni shtylle policia aty edhe i pushkatojnë. Nji shpi, na i kçyrum për veti e na gjujnë prej atuhit, na gjujnë shumë fortë. Kthehem te shpija, e tanë mas ni kohe shumë t'shkurtër fillon n'Prekaz.

Familja e Adem Jasharit, e cila Adem Jashari me Hamzën... edhe sindikatat e pamvaruna kur janë kanë që jonë largu, se Hamza ka punu n'fabrikë t'municionit n'Skenderaj, u kanë komercialist. Hamza u kanë aktivisti ma i fortë për t'drejtat e punëtorëve dhe t'shqiptarëve. Vllau i Adem Jasharit – Hamza, dhe Ademi. Baba i tyne u kanë ni msus, a baba i jem edhe baba i tyne... po mendoj, edhe Hamza edhe Ademi i kanë dajtë n'Llaushë, Gecët e Llaushës, dajtë i kanë me ni ven. Baba asht' kushëri me ta, shumë i afërt.

Edhe sulmohet shumë herë Ademi, nuk dorëzohet asnihere, nuk hekë dorë nga ajo. Vrahet familja e Ademit n'atë formë n'dytën ditë. Me qit profesorin jom çu une apet t'dytën ditë, dhe e kena pasë traktorin, po tani na e kanë marrë, na e kanë dëmtu. Edhe m'u ka dashtë me shku n'Prekaz dhe m'kanë dalë vet ata t'Prekazit e n'Ngojfile na i thojmë Prellovcit ktu Mikushnica, edhe s'um lajnë me shku anej se u kanë e pamundun me hi njeri i gjallë n'Prekaz prej armatimit t'ranë sa u ba. Se Prekazi asht' shumë i çuditshëm, nuk po thom që çdo gja asht' e mirë, po i ka... toka i ban trimat.

Edhe n'81-tën, me 13 maj "Dita e Ushtisë...Policisë Jugosllave" u kanë Tahir Meha ka luftu n'Prekaz. Tahir Meha. Tahir Mehën djali i mixhës tem e ka mik, e ka bijën e tyne ...çikën e mixhës t'tijna. Une jom kanë n'izolim n'Lipjan, kur ka... Tahir Meha kur ka luftu. Ato lufta tani jonë ba rrallë, po asht' për ne fati ma i mirë ka qenë që kena pasë inxhinierë t'diplomum u kanë, e ka kry n'Kroaci Fehmi Lladrovci, komandant e kena pasë. Dhe bile fort idhnohet ni rast, "Pse e bleve armën n'varfëri, kur unë ta kisha bo?". Ai e ka pasë ni shnjperkë 17 mijë marka amerikane u kanë. 12.6 e ka pasë ni shnjperkë t'fortë. Dhe, ma çon ni karikator me 30 fishekë si shpërblim. Dhe t'nejetin rast, ni karikator kur shkrun gazeta që jom konë pjesëmarrës, atë ditë që u vra Fehmija i fortë, po unë shumë i smutë prej unazave jom kanë dhe edhe ni karikator me 30 fishekë ma çon shpërblim tash Sabit Geci që osht' n'procedura. Sabiti e ata Gecët e Llaushës - dajtë e babës, edhe Adem Jashari dajë ata edhe Hamza, n'Llaushë.

Luftat jonë ba shumë t'randa, familja u kanë shumë e vujtne, mjetet i kanë pasë jugosllave shumë t'forta. Por shqiptarët unë po e thomë, atë ditë që u vra Fehmija, me dëshmi po flas, muj t'i dëshmitoj... shtatë veta jena metë n'pikë na u ka vra Zhevzhet Zeka, dhe i ka ra granata e asnji pjesë nuk ia ka lanë. Jena konë n'vijë ajrore 115 metra dhe e kena knu ni kangë, ni kangë që s'e kisha ni kurrë, e kena marrë, "Tuk le dilli, preron hana, zhuj Selmon, se boll bon nana" (buzëqeshë). Edhe nuk u ndëgjojke sa njallë, po na lloç shumë i madh, baltë shumë e madhe na ka metë teshat n'kanal, n'vijë. Ma n'zor jena kanë prej cungave, sesa prej plumave. Edhe gjysa janë damtu edhe shtatë vetë, nejse unë s'jom plague... qaty jena metë, s'dijshum as kah me ia majtë.

Lura Limani: Kur ka qenë kjo, a jeni konë...?

Enver Topilla: Kjo ka qenë me t'22-tin shtator 1998-tën.

Lura Limani: N'cilin katun ke?

Enver Topilla: N'Shkabë, n'Glladnasellë.

Lura Limani: N'Shkabë. A keni nejtë te shpija, a ku keni nejtë?

Enver Topilla: Nuk e di vendet ku jonë kanë.

Lura Limani: Po menoj, jo kshtu... gjatë luftës, gjatë luftimeve... kur nuk keni luftu, a keni qenë n'shpi?

Enver Topilla: Ja n'shpija s'ke pasë qysh rrin. Je kanë n'mal. Po nuk kom lëvizë se... u konë shumë interesant, do gjana jonë shku shumë pa dije. Se me ecë përpara t'ka nxanë çdo here plumi se toka e matne prej gjeodezisë së tyne, armët e tyne kanë gju larg. Po ata kanë gju kshtu e ti je dredhë {lëviz dorën në formë rrethi} rreth tyne, gjithë jena kanë n'lëvizje. Natën ata s'kanë lëvizë edhe pse janë kanë katërmëdhjetë punkte n'fshat temin, t'tyne, na kena flejtë çdo herë natën n'shpi t'djegne qashtu. Jena munu me gatu me metë gjallë edhe tani jena dalë n'mëngjes n'mal, gjithë n'qato male qaty. Kanihere veç je nalë, ke nejtë, s'ke ditë çka o' t'u bo se edhe shtazët na i kanë vra, na i kanë damtue, i kanë kallë me drithë e me krejt. Shtazët shkojshin [e pakuptim] se as shtazët nuk rrijshin vetun. Interesant, na i kqyrshum prej s'afërmi çdo gja.

Popullata o' bartë, ma s'shumti ka hekë popullata. Se edhe n'prezencën e tyne jonë vra shumë njerëz siç u vra baba jem, djemtë e mixhës edhe ata tanë. Edhe jonë vra... tash mendoje ni fshat prej 200 shpive, 78 t'vramë, ajo nuk asht' lojë, vrahen 40 vetë përniherë. Po te na asht' ni mungesë shumë e madhe, që kur çlirohemë nuk jem sa duhet qysh duhet për shkak se s'potencothen kërkun. Nuk asht' humbje me majtë përvjetore për njerëz që e kanë pshtu atdheun... po tash s'pe di unë, s'pi kuptoj njerëzt.

Lura Limani: Ku keni qenë kur ka përfundu lufta?

Enver Topilla: Kur ka përfundu lufta jom kanë n'fshat. Ka fillu lufta jom kanë n'fshat, ka përfundu lufta jom kanë n'fshat. Nuk kem pasë... dy here jom kanë n'Çyçavicë, ni rast e kena pasë shumë t'rancë me llaz Lladrovçin edhe dy vetë jonë konë t'tjerë, jena metë, thirret, ni Behadell i Gradicës, jonë ardhë aq shumë na kanë gju kah e kalojmë fushën. Te Dibranët e Gradicës u kanë e dedikume ni livadh prej ma se 30 mina hedhësave që na kanë ardhë prej Qirezi, dhe aty veç kur m'u ka nxe ftyra dhe toka e lagët dashtë Zoti, livadhi i lagët dhe ajo sharron shumë thellë dhe krejt lloçi {ngritë duart} dhe bi përbys. Thotë, "Oh a t'murre?", nisi me keshë thom "Jo, jo edhe ksi hovi pshtova". Deri i kena krejt ba nja 70 metra ma s'shumti, pesë mina hedhësa i kena pasë njo n'atë anë, njo n'atë anë {tregon me duar}, edhe apet kena pshtu.

Lura Limani: Çka ndodhi...qysh e keni marrë vesh që ka përfundu lufta?

Enver Topilla: Po, jena konë n'përcjellje, jonë konë. Na kena pasë edhe radio-lidhje tanë, u konë përcjellja e cila ka pasë edhe radio t'xhepit. Shumë interesant njeriu kur dojshim me ba ni duhan, fletorshe gjajshim dikun, i zijsnim fletoret. I bijshin ato vijat e ato, e tani prejshum ato me maru me mshtjellë ni duhan, qyshdo koftë kur dojshim me ba. Edhe bateriat e radios i rujshim shumë mirë, i shtijshëm n'ujë t'valë i nxejshëm, i pregaditshëm edhe e ndegjojshëm radion përfundimet. Jena konë n'rqedha gjithë, po t'thom, unë si unë me dëshmitarë po t'i boj 15 vetë me emra që unë kom raportu me

telefon t'Fehmi Lladrovci prej Verbovci ku me i ra NATO-ja. "Feronikelin" s'kom mujtë m'e pshtu, për shtatë ditë 32... 34 projektile i kanë ra, unë i kom raportu se e kena ditë çdo herë ku po shkon, çka po shkon.

A ditën e fundit prej tjerëve, kur jonë hekë policia e ushtria, djali i motrës tem 19 vjeçar Fitim Gashi, i knohet edhe kanga... jo Mentor Gashi, i knohet edhe kanga (buzëqeshë) edhe thotë, "Nuk e lo pa shku me i gju", edhe sipas komandantit, shok e kom Hysni Shabanit, thotë "Enver, 72 gjëzhoja t'automatikut që i ka gju djali n'ta". E kanë vra edhe e kanë gju n'pus. Pusi shtatë pashë a nantë pashë që e kanë gju aty, ditën e fundit n'Kjemë me 16 qershor m'doket.

Lura Limani: Çka ndodhi pas luftës, kur përfundoi lufta edhe u tërroqën krejt? Çka keni bo ju specifikisht?

Enver Topilla: Te shqiptarët partitë jonë të reja, shqiptarin partitë s'i dojnë, partitë jonë bo biznes. I gjithë populli u kanë n'Partinë Demokratike, n'Lidhjen Demokratike ku nuk jonë kanë... s'jena kanë t'knaqun as me ato për shkak veç me u hekë prej Lidhjes Socialiste edhe prej Lidhjes Komuniste njerëzit jonë kyçë cila parti t'ish dalë. Çka t'dush ti t'kishe mendu na i kishim me pranu atë s'po du me konë qitu edhe pse kurrë s'jom konë komunist, kurrë s'kom votu socialist, nuk du veç t'heket, populli, u hjekë popullata.

Po pas lufte tani e kanë fillu... edhe lufta ish kanë ba fort n'tri forma, siç m'thanë ata t'burgut. Ishin kanë ba do na thojmë "për shpirt e për rize t'Zotit", ajo fjala popullore që përdoret, do ishin kanë ba me mlu gabime t'familjes. Do kishin pasë ba pas lufte, jonë konë ushtarë me uzurpu me bo plaçka, me bo gabime edhe njerëzit n'tri forma edhe lufta ish kanë ka[kanë], t'cilën s'e kena ditë.

Bile, po kthehna ni insert mrapa, po jo s'osht' mrapa, osht' para, kur jena dalë n'fushatë. Jom propozu për këshilltar n'asamblenë komunale dhe kena shku n'Komoran, kanë fillu ata njerëzit me kalu me folë çka kanë me punu, çka do t'punojnë dhe unë s'kisha ndëgju kurrë pa marrë pjesë n'mledhje, veç kur jom nxanë me ketë [këtë]. Tybe, unë s'po di ata çka po thojnë, edhe unë jom me kta, po do t'punoj me krejt shpirtin realisht pa dallim partije ja feje për kit popull. Dhe votojna ma s'shumti për atë fjalë që e thom t'sinqertë.

Jena pas lufte, kanë fillu ndihmat t'mdhaja shumë. Nji rast, kur u shndërru, ishte fjala, pas lufte n'Prizren, jom kanë delegat me Shaban Shalën. Shaban Shala gjeneral, ka vdekur i denum politikisht. Edhe, me shumë shokë u kanë aty edhe Hashim Thaçi, jonë kanë krejt. Kena zgjedhë Lëvizjen e kena shndërru n'Parti t'Progresit, Lëvizja u shndërru n'Parti t'Progresit, Bardhyl Mahmuti u emnu kryetar i Partisë t'Progresit. Tani ni afat shumë t'shkurtë asht' formu Partia Demokratike e Kosovës.

Jom kanë anëtar i Partisë Demokratike t'Kosovës, po flas edhe nihere pa dallim partia, njeri pa njeri, n'cilën parti t'dush t'jetë s'lun rol shumë, dhe jom emnu zyrtarisht edhe kryetar i bashkisë edhe kryetar i partisë, nën-degës. Atëherë kanë fillu ndihmat dhe KFOR-i kanadez me Vilson vjen edhe aq shumë m'respekton n'realitet temin, dhe e thërrët Zvicrën zyrtare, dhe e lshon nji milion marka, Zvicra i lshon për ndërtim t'73 shpive n'fshat temin n'kategorinë e pestë. Fshati i parë që bahet me ni ndërtim ni kategori.

Po me t'vërtetë i katërti se i pesti asht' i djegun, i katërti deri t'parin. Dhe, m'ndihmojnë me krejt shpirtin ata njerëz.

Fillojnë shoqatat e t'denumëve politikë bijnë me kamiona tesha dhe gruja jem e ndjerë nuk i len n'oborr temin ato se shpijat krejt t'djegne. Po, thotë, "Çohni ku asht' vendi atje për me ia nda popullit", dhe ata thojnë "Këto jonë t'dedikume për kit person." Ajo thotë, "Mund t'mi hekni prej oborrit se asht' i nxanë dhe ai nuk guxon, me lejen e tijna nuk guxojmë t'lamë sende n'oborr pa i çu n'vend me i nda me popullin". Dhe u kanë i formum komisioni, e kom pasë Milazim... Karaçica thirret, nji djalë e ka ngjoftë fort popullin, m'ka ndihmu shumë dhe ai e ka nda n'atë mënyrën materiale. Kurrë nuk jom avitë as s'kom ditë çka ka ardhë e çka s'ka ardhë se s'jom kanë, nuk kom mujtë t'mendoj une me i pa njerëzit n'atë gjendje.

Dikur ju mrrinën kerret prej jashti e jo bonë pare, e bonë tre përqindsha¹ e bonë para, e u bonë tana. Shpesh s'kisha kah iu ndihmoj, thojsha, "Merrne ni thes mill ja diçka," masi kta s'po ju nihmojnë me shprazë kamionin a diçka.

Kur, ni rast n'Prishtinë t'denumët politikë në ni mledhje n'Kuvend çohen thojnë, "Na kanë ardhë 1200 litra vaj." Thotë, "E kqyrshim policinë ku jonë". E detyrohna se jom shumë i vrazhdë kur asht' e padrejtë. Thashë, "Jo bre, për ni fshat temin kanë ardhë noshta dhjetë mijë litra vaj e jo për ni shoqatë kaq t'madhe 1200, turp për juve!" A din kështu po shprehna n'atë mënyrën ma banale. Dhe ju ndihmohet njerëzve me krejt shpirtin, po jom kanë shumë i ngarkumë për shkak se jom marrë kufoma shumë.

Masi ma kanë vra babën, babën ma kanë gjue edhe n'pus, na u ka dashtë me shku me i tërhekë, na s'kena mujtë mi varrosë. E kanë marrë e kanë gju n'pus. Dhe, mas katër-pesë mujve jonë ardhë e kanë nxjerrë, e kom bo vorrimin, jom marrë me kufoma me delegacione t'huja me njerëz. E kom kputë nashta, kah e nxjerrim prej istikameve tona që i kanë ba n'shavarinë kufomat, e përbashkëta, e kom kputë kufomën, kur e kom kapë për rrypi dy copësh m'ka ra se jonë moçmu n'dhe pesë-gjashtë mujë. A n'krejt kohën, zorin ma t'madh e kom pasë me pregaditë përvjetorin, m'kanë nihmu shumë kyretarët e fshatërave edhe suita. Kanë ardhë shumë delegacione t'huja e njerëz n'ndihmë, shtatë vjet i kom majtë përvjetoret për 215 n'formën ma t'fortë, dhe pas shtatë vjete asnihere ma s'e ka majtë kërkush. Se emnohen ata njerëz që s'kanë vujtë kurgja, veç me u pasunue.

Pjesa e Tretë

Tani, si kuvend e kena pasë rrugët, e kena pasë ujin, kena pasë... dhe unë bohna i cili çohna pa rend dite, pa procedurë, e kërkoi Likoshanin dhe që ka kërsitë pushka e parë si n'Vlorë, dhe shpallet Likoshani n'Kosovë që ka kërsitë pushka e parë, se jom konë kryetar i bashkisë n'Likoshan n'Qirez. E tani fillu

¹ "Fondi i tre përqindëshit" u nis në vitin 1992 nga qeveria në ekzil e Republikës së Kosovës e udhëhkur nga Bukoshi. Fondi financohej nga shqiptarët në diasporë dhe Kosovë, të cilët kontribuan duke kontribuar me tre përqind të pagave të tyre mujore në kontot e Republikës së Kosovës.

rrjedha, jeta, punë, njerëzit... jom konë edhe n'bord administrativ për emërim t'drejtoreve t'bordit. Po s'i kuptoj, nuk jom faktor t'merresh me politikë, duhet m'u kanë politikan. T'merresh qysh bahan tenderet ja hajnia, duhet me kanë i atij rangut... s'du me hy n'ato procedura as çka bohet. A ni humbje e shtetit, me krejt shpirtin, o' tenderi!

Kaltrina Krasniqi: A mundemi veç pak me u kthy n'fillim?

Enver Topilla: E kom përcjellë nji ditë akademik Mark Krasniqin, po m'tërqethet trupi t'foli. Dhe, krejt punën që e kishte ba njeri m'ka shti ndoshta me kajtë me mendu aq shumë pse njeriu i parë që largohet nga pushteti, nga udhëheqësia jugosllave, që deklasohet si njeri. Se ma thojnë edhe mu njerëzit, thojnë, "Pse bre Enver atëherë je kanë *nepodoban* serbisht fjala, tash je i papërshtashtëm, pse s'po i përshtatesh?" Padrejtësisë, nuk muj!

N'klasën e parë shkollën fillore kur e kom kry, atëherë jonë shpërbly nxanësat, jonë kanë... varfëria u kanë n'nivelin ma t'lartë dhe kom qenë... msusin e parë e kom pasë Veli Gjinovcin prej Makermalit t'Drenicës dhe shpërblehna me librin nga Mark Krasniqi, ky libri... e kom aty n'librari, "Posta e Porositun" si nxanës, me "Posta e porositun". Dhe, si tanë fëmija, s'kom pasë dallim t'posaqëm e shkolla asht' shumë e fortë. Nji proverb popullor arab për njerëzit e pashkollum thojnë, "Ni hajvan n'fotografi t'insanit". Shkolla osht' mbi të gjitha. Jom kanë si të gjithë fëmija, me vujtje pak ma t'mdhaja po...

Kaltrina Krasniqi: A keni pasë motra a vllazën?

Enver Topilla: Po, i kam pesë motra e nji vlla. Vllau i ka pesë fëmijë, pesë djem. I ka me fakultet t'tanë, edhe ai si unë. Asht' teknik i dhamve, e kanë nji ordinancë. Asht' kanë nji ushtar i fortë, i shëndetësisë, asht' edhe invalid i luftës. Dhe, n'80-tën, nji vit para '81-tës qì jonë burgosë, u shku ushtari i jugosllavit, u shku n'Maqedoni ma kanë çue, kazerma Marshall Tita. Kur u bo betimi jom shkue nuk u dalë n'betim hiç, u betue te shpija që "Betohna s'kom me u betue, 'Shokut Tito t'i betohem". Dhe ma kanë çu n'burg, n'Goce Dellçev, ma kanë majtë dy mujë n'burg.

Njeri pas njeri jom shku jom konsulltu me nji aspirant, me nji flamurtar boshnjak ka qenë, u kanë i burgut. Dhe, njeri pas njeri m'u ka dashtë t'i dha 20 mijë marka dhe e kom nxjerrë prej burgut, se s'u betu. Dhe, s'kisha çà me i ba, baba bërtitke, "Pse, a pak po hiqni a?" Thojsa, "S'e don Titon, s'kom çà me i ba" (qeshë).

Lura Limani: Ky vllau ma i vogël ka qenë apo?

Enver Topilla: Unë jam fëmija ma i madh, e ai shtatë vjet e gjysë asht' mas meje, kur u ardhë baba prej burgut. Tani motrat i kam, motra jeme mas tijna që asht', e ka djalin dëshmor Mentor Gashin. Të gjitha motrat i kanë fëminë të gjithë me fakultet.

Lura Limani: Ku keni qenë ju në shkollë fillore? A keni qenë n'katund n'Shkabë, a keni vazhdu...?

Enver Topilla: Jo, atëherë shkolla fillore asht' kanë në Dritan n'Dobroshevc. Asht' kanë larg, jena konë s'di sa fshatëra, po tani me ni vonesë shumë t'madhe asht' ba shkolla tetë vjeçare aty. E kom pasë ni pauzë mjaft t'madhe, se s'kom pasë ku me shku me katër vjet. E pasanenaj ma s'pari u ba n'Drenas, e tani kanë fillu këto shkollat... vonesë shumë e madhe.

Kaltrina Krasniqi: E mas shkollës fillore a keni shku n'shkollë t'mesme?

Enver Topilla: Shkollën fillore kur e kom kry jom shku n'shkollë t'mesme, po jom shku n'shkollë privatisht se s'mkanë lonë me shku. E kom kry shkollën e mesme n'Zveçan n'Mitrovicë, dhe Shkollën e Naltë t'industrisë e kom kry n'Mitrovicë n'atë anë ura, shkolla teknike n'atë anë atëhere u kanë atje. I kom kry, po çdo herë m'u ka dashtë, kurrë s'kom mujtë ktu veç çdo gja m'u ba ilegalisht për shkak t'familjes.

Kaltrina Krasniqi: N'vitin 1981 sa kohë keni mbetë n'burg ju? Sa keni qenë gjatë aty?

Enver Topilla: Une e spjegova edhe pare, ma s'pari jom izolu n'natën e majit me 30 prill, jena izolu 120 vetë na kanë çu n'Lipjan pa procedurë gjyqësore.

Kaltrina Krasniqi: A keni naj ide psejeni izolu, veç për shkak t'prapavisë familjare, apo ka pasë naj arsyé?

Enver Topilla: Jo, izolimet jonë ba me gjoja që ka ndikim n'popullatë. Dhe unë izolohna për shkak t'Amortizerit se m'kanë respektu shumë njerëzit dhe n'79-tën jom çu kundër Reno Servisit t'Beligradit, kundër Beligradit, kundër padrejtësive. Dhe tani çdo t'shtune t'dille kur jom shku n'fshat m'u ka dashtë me lajmru n'stacion t'policisë n'Prishtinë, se e kom pasë prej '69-tës banesën e shtetit, u thirrke n'serbisht "Samački hotel", hoteli i t'vetmive [të vëtmëve]. Nji banesë t'vogël, e kom shitë tani ata para gjashtë vjete, edhe pse ma kanë marrë habitati, tani ma kanë kthy. Ma kanë marrë edhe banesën n'Lakrishte, 76 metra katror, kur jom ra n'burg e tani ma kanë kthy. Dhe, qato janë... izolimi u ba, izolimi o' pa gjyq, veç me ni nënshkrim, neni 46 o' kanë: "Asht' kanë ndikim n'popull, asht' i rrezikshëm." Dhe jena shku me krejt intelektualët, u kanë aty edhe kryetari i Podujevës, që u kanë llaz Pireva, u kanë Dibran Bajraktari. Jonë kanë shumë njerëz eminentë që jena kanë aty, 120 vetë.

Dhe ata i kanë lshu e tani jena metë veç shtatë-tetë vetë. Mas nji muji i kanë lshu krejt, tani m'u kanë vazhdu mu edhe 15 ditë aty. Edhe m'kanë çu n'Mitrovicë, m'kanë marrë m'kanë çu n'burgun e Mitrovicës, n'atë anë ure asht', nji burg, e tregova, shumë i vrazhdë, burgu ma i keq që ekziston, italiania ka bo vetëvrasje. Dhe aty ni podrum që nuk e kena njoftë, teshat çarshafat çfarë ngjyre kanë, se n'derë na kanë çelë nji katror, shkojshim me ren me marrë frymë aty, se veni shumë i ranë, 15 vetë jena kanë. E pas atyhit, tani pas tre-katër mujve, izolimi m'patën shti n'vepër penale dhe i kom majtë edhe dy vjet. Po, i kom majtë edhe gjashtë mujë n'spital, t'tregova, n'burg qendor t'Jugosllavisë prej maltretimeve, tjerat i kom majtë n'burgje, n'Ferizaj, n'Prishtinë, n'Sarajevë, n'Mitrovicë, n'Foçë, në t'gjitha burgjet, n'Belgrad, tana burgjet jugosllave.

Kaltrina Krasniqi: A keni qenë zakonisht nëpër seksione me t'burgosun tjerë politikë, apo ka qenë...?

Enver Topilla: Ja, nuk ka veç t'burgosun politikë n'burgje, po une nalna e mendoj kur e thojnë për Adem Demaçin, "Ja e ka bo këtë gabim, ja s'e ka bo". N'shtëpi përmirsuse ka fabrika, ka n'Nish, ka çdokund. Siç asht' për shembull, përpara u kanë edhe n'Istog, n'Dubravë. Asht' kanë edhe ky burgu që asht' te Vushtrria, ka fabrika, ka bujqësi çka merren...

Na jena kanë atje 17 t'denumë politikisht n'Foçë, na kanë çu prej Sarajeve, po unë e kom pasë një tretman krejt tjetër për shkaqe shëndetësore që ma kanë dhonë mjekët. Dhe, jom shkue kanihere kom punu n'fabrikë, aty i kom takue edhe ata tre fratër të kishës t'Dunës, dy frajoza edhe ni fra Ferdinando, ai frat Ferdinando ka qenë përsëdyti herë i dënum kah 15 vjet, njerëzit ma eminentë përllogari teme po flas.

Mos m'keqkuptoni naj formë për kto që po e thomë. Dhe, na s'jena përzi me ta, as n'shëtitore s'na kanë dalë me na pengue, na kanë respektu edhe t'burgosunit, jena rujtë shumë për shkak s'kena dashtë na me pasë punë me kërkon, absolutikisht! Ka pasë edhe shqiptarë për vrasësa atje nëpër Sarajevë e nëpër Jugosllavi kah t'dush.

Na jena konë shokë n'mes veti, jom konë me Nazmi Selmanin u konë kryetar n'Deçan, vllaun e ka tash kryetar t'Deçanit, jom konë me to. Jom konë me ni Jashar Salihun... ai asht' gjeneral, ka vdekur, u kanë profesor i anglishtës. Jom konë me Alush Thaqin, asht' drejtor i shkollës n'Llapushnik, dhe me shumë shokë që jena kanë atje bashkë. Kurrë s'e kena pasë një t'keqe, a ne n'burg na kanë pa që na e kena pasë, edhe serbët edhe boshnjakët edhe t'burgosnit... se atje ma shumë për dhunime për gjana t'kqija dënohen. E kena pasë, thotë, ni epror, ni prind, ni familjar që na e ka eduku Adem Demaçin. T'burgosnit thanë. A na mujmë me folë keq për to, për ni njeri siç asht' ai, (buzëqeshë) duhet m'u çu n'kamë m'e përmen.

Lura Limani: Pasi që jeni liru, a jeni kyçë... a keni qenë një ndër pjesëmarrësit, e përmendët që edhe me babën keni punu n'pajtime t'gjaqeve n'formën tradicionale. Kur ka fillu iniciativa me Anton Çettën me disa të burgosun tjerë, ish-burgosun politikë, a keni marrë pjesë në këto pajtime?

Enver Topilla: S'di ku e lashë një fotografi kur jena konë... {kërkon në xhep},... ni herë kur i kena nxjerrë eshnat e Fazli Grajçevcit me shokë, jonë fotografitë me Shaban Shalën, me Jakup Krasniqin, jom i afërt, jom kanë shumë me ta. Po, te na asht' ni traditë krejt tjetër se m'u ka dashtë babën t'ë përcjelli çdo herë. Leje Labinot {i drejtohet të birit të pranishëm}. A çdo herë jom kanë pjesëmarrës, jom kanë çdo herë pjesëmarrës për shembull i pajtimeve, po jo çdo herë, mos m'keqkuptoni. Aktivitetet e mijës jonë konë pak ma t'randa se dikush asht' dashtë me majtë familjen nashta m'u ka dashtë shumë herë me punu dashte pa dashtë punë fizike për me majtë familjen, se baba jonë u kanë i pamundshëm, por kur o' dashtë me babën, e kom çu veç naj here. Edhe çdo here e kom pasë ni respekt, a i dallum posaçëm siç asht', kryesor çka jena, ata nuk mun i zavendson kërkush po aktivist jom kanë n'përvjetore, n'maresa [n'përfundime] e n'gjana, edhe pas lufte edhe para lufte.

Lura Limani: Mas luftës, bashkë me Shukrije Gashin keni bo ni iniciativë tjetër për pajtime. A mund t'na tregoni pak ma shumë për qat iniciativë?

Enver Topilla: Pas lufte komuna i ka çu kah tre-katër vetë prej Kuvendit po flas, prej Asamblesë t'Kuvendit Komunal, dhe jom kanë unë, Enver Deliu i Obrisë që iu ka vra krejt familja edhe fmija gjashtë javësh, ni Halit Vorani. Jena kanë katër-pesë vetë dhe jena kanë shtatë komuna, po mendoj sa jom konë unë. Tash marre asht' me thanë që jom shpallë ma i miri unë me Ymer Deliun.

Dashtë Zoti se neve na u përputhke se Shukrije Gashi o' kanë e dënume politikisht, Shuki. Asht' kanë e fejume me Nuhi Berishën dëshmor ai... i kombit dhe çdo përvjetor, çdo rast, çdo punë, çdo... m'ka ardhë n'familje gjithë, me shumë njerëz.

E kena pasë një rast shumë t'rënë n'fshatin tem, sa nashta m'u ka dashtë ditën a natën me shku kur u nalë besa a diçka, se jonë vra... s'po flas për çka, do nërmjet veti do kushëri. Dhe shumë herë noshta jom konë i vrazhdë se m'u ka dashtë m'i blloku kur s'u kanë mirë, se i kom njoftë mirë rastet. Dhe tani e kom thirrë Shukin, o' ardhë edhe Shuki, kryetari i Komunës, jonë ardhë shumë. U ardhë telivizioni e krejt, pajtimin e parë që u ba, jom konë iniciator dhe e kom ba... as s'e kom pranu me u shpërngulë kojshia prej atyhit, as me pagu atë gjak, as absolutikisht sen. E kena bo ni pajtim shumë t'sinqertë.

Edhe tani çka ka ndodhë këto tjera... me përjashtim që kohën e fundit edhe fillova me u rënu pak prej smujave. Se m'u dashtë me u ba operacion prej unazave, ni operacion t'rändë, tani edhe tensioni meta n'sallë. Edhe m'u rëndu hovi, jo, "Shkoi te burri", jo "M'veti, s'mveti", "Jo u martu, jo e lshoi" ... ato jonë gjana të cilat, jonë gjana normale, edhe fetarisht duhet çika edhe djali me u njoftë nërmjet veti, me u martu. Po tani qysh ma murre, qysh m'shkoi, qysh e boni, e kesha thojsha, "Na n'nissħem me u marrë me qito punë jemi barazi me zero".

Dhe kur u dashtë jena shku po tash pak ma lehtë asht' se për shembull edhe gja mos ditë, kur shkon baba i Fehmi Lladrovcit, shkon vllau i Adem Jasharit, shkon ajo... mu ishalla s'm'ndodhë diçka se me m'ardhë ata s'kom qare pa e falë gjakun, çka muj t'i boj. Se thotë, "M'u ka vra t'u luftu për ty e për mu", ja diçka "e ti p'i pengon këto gjana". Tash asht' shumë ma lehtë do gjana, e edhe pse babën e kom dëshmor, une ato s'muj t'i baj asi fore me ia nxa krytë kërkujna pse...se duhet t'dihet realiteti.

Kam njerëz mjaft, m'respektojnë pse n'rast që ta kom bo ni t'mirë, s'ta kom pi kafen kurrë. A kështu t'kom pytë, "A ki pare, shkojmë n'kafe?" edhe kur s'kom pasë. Kur s'kom mujtë me t'bo t'mirë jom smu pse s'po muj baj mirë. E kom leju, ka qenë ni respekt ndaj njerëzve shumë, ndaj profesorëve, ndaj njerëzve, ndaj shokëve. Plus, i falemnderoj fmitë se thojnë, "Asnjëherë s'na ke ngushtu për fmi", se kur djalin e kom pasë n'Mitrovicë, sa herë, ata t'njofshum krejt i kom pasë, sa herë kom dashtë me shku me pi ni kafe, thirrke me telefon nanën e vet, "Oj nanë, që vjen baba une s'hi n'provim". E jom rujtë shumë, s'kom dashtë me shkelë as ftyrën e babgjyshit, as t'babës, as temen, se bajraktarllaku nuk trashëgohet si dikush "Jom i bir bajraktari, e s'len gja pa ba". Bajraktar o' qai që e ka bajrakun n'deti, flamurin siç thojmë na, e jo brez mas brezi. Une muj t'e koriti babë e babgjysh, jo që s'jam njeri i mirë, po duhet t'kam kujdes t'posaçëm.

Kaltrina Krasniqi: A keni ditë n'familjen e juj për historinë Shaban Polluzhës? A ka qenë naj rrëfim që ju ka përcjellë gjatë jetës?

Enver Topilla: Shaban Polluzha e ka pasë, djalin e ka gjallë Ramadanin, djalin e fundit, ma t'voglin. Dhe, asnihere nuk asht', s'ka shku nga ajo me e ba nji veprim si të tjerët. Ajo kohë ka qenë shumë e randë. Na jena kanë para lufte n'shkollë t'Tërsenikut, e kena majtë ni përvjetor t'Shaban Polluzhës. Sali Berisha e ka dekoru me medalen e artë, kryetari i Shqipërisë, dhe jena shku na kenë ba ni aheng, drekë na e kanë ba n'Polluzhë, na thojmë Thana, ni vend ni lëndinë. Dhe na kanë rretheku aq fort policia, saqë do ata që po bajnë libra i thojnë dajës, "Çu mixha Ramadan ti shko merru vesh." E unë çohna. "Jo, çu hajde shkojmë unë e ti se ky s'ka nevojë." Na ja kena ba përvjetorin.

Jakup Krasniqi e man fjalimin, dhe për Shaban Polluzhën, nuk e di unë qysh te mendoj, ni njeri me 12 mijë ushtarë, kohnat jonë kanë po... edhe nihere po e thom që derisa nuk ka, prej akademikut deri n'bujkun, fitorja kurrë s'asht' e jotja.

Atëherë s'ka pasë akademikë, s'ka pasë gjana, jonë konë t'përbashkët, jonë kanë t'shtypun prej... Ali Shukria, Ali Shukria. Kur u kanë prokuror publik, kanë denu njerëz me vdekje. Thjesht pushteti jugosllav nji qind mandate siç kanë qenë ata tjerët. Ja Veli Deva dhe Ali Shukria e Veli Deva që m'dhimet shumë djali i Veli Devës, u kanë djalë i mirë, ai doktori. Njani u kanë sekretar partie n'Skenderaj, njani prokuror publik, ndoshta sa lufta kanë dëmtu njerëz. Po, s'po du me i hi n'ato procedura, s'janë të mijat, veç s'jet populli. N'rast që ni popull, asht' me ni hero t'popullit, ai s'o popull i mjaftushëm. Populli shqiptar ka herojë sa t'dush. Tjerë jonë do që kanë udhëheqë.

Kaltrina Kransiqi: Ekziston nji bindje që mas Luftës t'Dytë Botnore, specifisht nuk osht' investu n'zonën e Drenicës.

Enver Topilla: Une po e thom, n'koftë vetëm Drenica n'Kosovë, edhe ajo mos koftë. Po, atë çka po e thu ti, nuk asht' shumë e mirë se serbët e kanë nji fjalë, "Ju te shqiptarët kur po u rrzojke njeri, veç me ja dhanë dorën, e ju e shkelni edhe me kamë". Drenica u shkelë me kamë veni ma i varfëri o' Drenasi n'krejt komunat, a veç n'Komunën e Drenasit, jonë përmi nji mijë vetë t'vramë. Unë po thom, n'bashkësi tem jonë 200... 215 vetë.

S'asht investu atëhere kurrë se u kanë i shtypun. Se tash me çka i shtypun? Jo Azem Bejta, jo Mehmet Delia, jo Shaban Polluzha, jo po na kundërvyhet ky e ai, çdo herë. E vëtmja ma e dallumja u kanë Drenica, që asht' sulmu ma s'shumti gjithë. Po tash edhe pas luftës diqysh ka metë se n'Drenicë duhet me investu shumë, për me u pa çka po investohet se çdo gja ka qenë zero, çdo gja n'zero. Edhe ma i zhvillumë asht' ni fshat me i marrë tjetër kun, po flas se Komuna e Drenasit, për llogari temen po flas. Pse para lufte asht' investu veç për keq, mirë kurrë s'asht ba, ni kafshatë bukë për Drenicë. U kanë, zaher, e ka kapë veri ma shumë, a s'e kanë dashtë të tjerët a, po...nuk jena metë, shqiptarët s'kanë pasë nevojë m'i dashtë i huji.

[Pjesë e prerë nga intervista: intervistesja e pyet të intervistuarën për jetën në fshat, "Ju jeni rritë n'katund, qysh ka qenëjeta? A mundeni me na pëershkru pak?"]

Enver Topilla: Jeta n'fshat atë çka unë e maj n'men, ato fshatëra jonë marrë veç me bujqësi. Ka qenë ni jetë shumë e randë, se tash ti s'ke pas qare pa majtë lopë për me e pagu tatimin e ranë. Bile, nuk asht' as... po asht' e vërtetë, dhe jonë qitë shumë haraqe n'varfëri. Ni vend, shkruan për fshatin tim - pesë qind killa pasul. Dhe ni shqiptar që o' marrë me ato aktivitete thotë, as gjuhën s'e ka ditë mirë shqipe, thotë, "Qitja edhe ni *nulla* [zero] përmas se prej pesë qindëve ta ka bo pesë mijë", na pesë mijë kilogram grun s'i gjajshum.

Dhe ata grun çka u dashke me i mjellë, u dashke t'gjithë me i shitë n'Mitrovicë për shkak me pagu tatim shtetit. Ose me bo naj martesë, jonë konë ato adete, traditat e shqiptarëve. Nuk kisha me thanë që...muj t'thom tre-katër vjet, ja pesë-gjashtë vjet para lufte, kanë mujtë me marrë frymë shlirë, lirisht shqiptarët n'pjesën tonë se të gjithë jonë kanë t'vujtun me krejt shpirtin prej varfërie, prej mundimeve, prej maltretimeve, mungesë shkollimeve, gjanat krejt janë kanë shumë t'rana. A din, po flas për vjetët të cilat unë i maj n'men.

S'muj i përshkruj kushtet që unë i maj n'men, s'muj i përshkruj kushtet ja jetën. Se kurrë nuk e kena ditë na, çka asht' për shembull ni pulë përveç kur kena pasë festa fetare, se kombëtare atëherë s'ke pas ti festë kurrrëfare. Bajrama shembull p'i baj. Ose, kurrë nuk e kena ditë na çka asht' buka e gryftë, buka e grunit, se o' dashtë krejt ata me i shitë për tatim, për martesë ja diçka, veç t'misrit, vujtjet... qashtu me shpirt.

Lura Limani: E përmendët edhe ma heret, me na tregu do pjesë t'kangëve. A i bini ndonji instrumenti? A keni knu kur keni qenë i ri?

Enver Topilla: Jo, çiftelisë di me i ra pak, çiftelisë. Po, ni popull u dashtë me metë gjallë në ni formë, se tash shqiptarët e kanë ni t'posaçme... t'botës, edhe flamurin, edhe kangët, se na kem me bo demantë edhe me Annën [di Lellion], dhe i tregova asht' shumë e arsyeshme t'shkojsh n'Beligrad t'gjojsh librin e leximit, "Čitanga" shkrunk n'libër t'leximi, edhe serbet i thojnë, "Hej Milošu arnautsku kopile," O Millos, kopili i shqiptarëve, i thojnë shkijet. Dhe, populli asht' ma i gjanë me kangë, se edhe me veshje kombëtare, po ma shumë me kangë.

T'hotë kush asht' ma i mençmi, atëhere e kanë konsideru ma t'mençmin, ja hoxhën, ja ma s'budalle barinë jo diçka, e kon kangëtarin ma t'mençmin se prej ni fjale i ka ba nji qind, dhe o Zoti t'rujtë, o Zoti t'nihmoftë, po çdo herë t'ka ka përshkru, ndoshta ka mujtë me kanë i dedikum, "Shko ti kno kangë patriotike, tani me i tubu njerëzit kush p'i përkrahin a çka po ban." E çdo herë t'kanë tregu që ti je shqiptar me vujtje me mundime, se unë po thom ato çka janë shumë ma interesant.

Une me i hi qitash "Postës t'porositun" para 60 vjete përmi kur i kom pasë, e di të gjitha gjanat çka ka shkru Mark Krasniqi se m'kanë metë n'shpirt si fmi, e le mo do kangë patriotike, knohen shumë kangë patriotike, shpesh thom, edhe mos konë koftë qashtu, bile mirë asht' a din (buzëqeshë). E, i kom adhurue, jo une, po t'gjithë shqiptarët. Dhe, t'ka tregu n'fund t'fundit që ti je shqiptar.

Lura Limani: A keni diçka tjetër me shtu? Na nuk kena mo pytje, kshtu që çkado që kishit pasë qef me thonë përfund.

Enver Topilla: Veç ju kisha thanë, prej natyrës tem edhe mos baftë hiç, kom qef me kanë shumë i saktë. Fjala mbetet, fjala, shkrimi o' vepër. N'rast që nuk kom ditë shumë gjana, a i kom lonë mangu, mos ma shihni shumë për t'madhe. Kom folë, i kom ba ma t'vogla sesa që u dashtë me kanë. Dhe, t'vetmen fjalë mund të thom, e falemnderoj ma s'pari Zotin pse jam shqiptar, i falemnderoj t'gjithë ata që ia kanë kushtu atdheut jetën mbi t'gjitha.

Dhe falemnderoj familjen tem, të gjithë familjen tem, edhe të gjitha familjet që ia kanë kushtu me çdo shpirt atdheut, mburrna, falemnderoj tash edhe gjeneratat e reja, fëminë e mi që asnihere s'kanë me thanë, "Bre, babë shumë i mirë je kanë, po paske pas vjedhë se s'ke mujtë me kit rrögë me na bo kit pasuni". Falenderoj që m'respektojnë, e kanë kry shkollën me nder, i falemnderoj juve se o' shumë interesant, nana çdo herë n'shpirt duhet me kanë ma e shkollume se baba, se edukata e fëmisë asht' mbi t'gjitha. Ju falemnderoj që keni ardhë, ju falemnderoj që keni gjetë kohë, ju falemnderoj që pe marr si respekt shumë t'madh. Nuk e kam princip me u eksponu shumë, po juve po e llogaris se me ju pasë fmi t'mi, dhe Zoti ishalla ju nderon ju edhe familjen e juve edhe të gjithë popullin shqiptar.

Për luftë, për punë për nder çà kanë ba, hallall ju koftë të gjithëve. Kush ka gabu, le t'përgjegjet.

Lura Limani: Falemnderit shumë, shumë falemnderit për kohën.